



**Republika e Kosovës**

**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**

***Kuvendi - Skupština – Assembly***

---

**Legjislatura IV**

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 70/12

Prishtinë, më 12.06.2012, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-203.

**PROCESVERBAL**

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA**

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadërgjonaj, Naser Osmani, Sali Asllanaj, Latif Gashi, Muhamet Mustafa, Albana Fetoshi, Xhevdet Neziraj, Duda Balje dhe Hasime Krasniqi.

Munguan: Jelena Bontic dhe Hykmete Bajrami.

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Ramadan Avdiu, zv. Ministër i Financave, Qerkin Berisha, Drejtor i Dep. Ligjor në MF, Ymer Havolli, Adrian Zalli dhe Vërshim Hatipi nga TKPK-ja, Ekrem Hoxha Kryetar i ART-së, Ismet Krasniqi, Emrush Haxhiu dhe Istret Azemi nga Kuvendi i Kosovës, Alexander Beetz, Rejhane Zylfijaj dhe Ramadan Islami nga GIZ, monitorues nga KDI dhe OSCE.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Dashurije Canolli, Ardita Fejza (praktikante) dhe Kushtrim Aliu (praktikant).

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadërgjonaj, Kryetare e Komisionit.

**Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:**

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me emërimin e anëtarëve në Bordin për Rishqyrtimin e Ankesave;**
3. **Shqyrtimi i Raporti vjetor të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2011;**
4. **Shqyrtimi i kërkesës për miratimin e ndryshimit të taksës menaxhuese të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës;**

5. **Shqyrtimi i Raportit financiar vjetor të Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit për vitin 2011;**
6. **Shqyrtimi i kërkesës buxhetore të Kuvendit të Kosovës në bazë të Qarkores së parë të Ministrisë së Financave 2013/01;**
7. **Të ndryshme.**

#### **1. Miratimi i rendit të ditës**

**Kryetarja**, hapi mbledhjen dhe propozoi rendin e ditës.

Rendi i ditës miratohet pa ndryshime.

#### **2. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me emërimin e anëtarëve në Bordin për Rishqyrtimin e Ankesave;**

**Kryetarja, njoftoi se** Komisioni për legjislacion ka dhënë vërejtje rreth amendamentit 6, neni 4. Ka kërkuar rishqyrtim. Citon amendamentin e dërguar nga komisioni për buxhet. Në rekomandimin e këtij komisioni nuk është specifikuar se çfarë të ndryshohet, ne kur dërgojmë rekomandime japim formulimin se çfarë duhet të jetë.

**Albana Fetoshi:** Kam një vërejtje paraprakisht. Në mbledhjen e fundit të Komisionit për Buxhet dhe Financa, kur është shqyrtuar kjo çështje nuk kam qenë e ftuar. Dua ta di arsyen.

**Kryetarja**, stafi i administratës i kanë lajmëruar të gjithë në përjashtim të Dudës që nuk është lajmëruar, kurse anëtarë tjerë kanë qenë të ftuar.

**Albana Fetoshi**, kam biseduar edhe me anëtarët e tjerë të komisionit dhe kanë thënë që është tentuar të mbahet një mbledhje por për shkak të kuorumit nuk është mbajtur dhe kam kërkuar të më lajmërojnë për arsye objektive nëse mbahet ndonjë mbledhje tjetër. Mendoj që është obligim i juaji si Kryetare të më lajmëroni sepse keni lajmëruar të gjithë anëtarët e tjerë të komisionit personalisht për të marrur pjesë dhe kishte qenë mirë të isha edhe unë pjesë e mbledhjes. Sa i përket amendamentit 6 nuk pajtohem me këtë formulim, sidomos përmendja se është në pajtim edhe me nenin 36 është kontradiktë shumë absurde dhe krijon dykuptimësi dhe nuk është mirë i precizuar.

**Latif Gashi**, ka dominuar mendimi i përgjithshëm i anëtarëve të komisionit që përafërsisht të shkoj ky formulim. Kemi vërejtje nga komisioni për legjislacion dhe varësisht nga ajo çfarë kemi dëgjuar nga stafi mbështetës vërejtja është pse është shkruar “në çdo kohë do të kenë përparësi” dhe propozoj të hiqet kjo dhe të themi “ky ligj do të ketë përparësi mbi të gjitha ligjet dhe aktet e tjera nënligjore”.

**Sali Asllanaj**, për vlerësimet e komisionit për legjislacion që ka thënë është anti kushtetues duhet të gjejmë një formë të bashkëpunimit që ta rregullojmë si ta bëjmë. Ata janë më kompetent për të vlerësuar atë punë përndryshe më duket një variant i qëlluar dhe objektivisht ky ligj duhet të ketë primatë ndaj ligjeve tjera.

**Xhevdet Neziraj**, për shkak të transparencës prof Mustafa në mbledhjen e kaluar dha një propozim që mund t’i eliminoj këto gabime sepse sipas nenit 36 ligji i Menaxhimit të Financave

Publike has hezitim pasi ky ligj ka kaluar dhe është i tillë që mund të hiqet të përshtatet dhe ta tejkaloj këtë problem. Nuk jemi të interesuar të bëjmë ndonjë bllokadë që të bimë në kundërshtim me FMN-në sepse jemi të interesuar ta ruajmë buxhetin.

**Muhamet Mustafa**, me këtë propozim kërkohet të zbatohen ligjet që i ka aprovuar Kuvendi dhe i jepet prioritet ligjit për menaxhimin e financave publike.

**Qerkin Berisha**, sa i përket nenit 36, ky nen e lejon Qeverinë të bëjë shkurtime sa i përket buxhetit në raste të caktuara. Qëllimi i këtij neni është që ligji në tërësi të ketë përparësi me ligjet tjera.

**Muhamet Mustafa**, ky nen nuk ka pasur nevojë të futet. Neni 36 është bërë kur Kuvendi ende nuk ka pasur kompetenca dhe i jep shumë kompetenca Ministrit dhe Qeverisë dhe duhet çdo ndryshim esencial në buxhet të lajmërohet parlamenti. Situata e krizës mund të jetë për një kohë të shkurtër dhe parlamenti duhet të njoftohet për çdo gjë.

**Naser Osmanaj**, e ndryshojmë kështu: në rast mospërputhje me ligjet dhe aktet e tjera nënligjore që kanë të bëjnë me shpenzimin e parasë publike, përparësi do të kenë dispozitat e ligjit për menaxhimin e financave publike edhe kur ka të bëjë me nenin 36 të ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Pas diskutimeve, Komisioni me një votë Kundër (Albana Fetoshi), asnjë Abstenim dhe të gjithë anëtarët tjerë Për, riformuloi amendamentin 6 si në vijim:

### **Amendamenti 6**

Neni 4, riformulohet si vijon:

#### **Neni 4**

1. Në nenin 81 të ligjit bazik, shtohet paragrafi i ri 81.1., me tekstin si vijon:

81.1. Në rast mospërputhje me ligjet dhe aktet e tjera nënligjore, që kanë të bëjnë me menaxhimin e parasë publike, dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, do të kenë përparësi, në pajtim edhe me nenin 36 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

2. Paragrafët 81.1, 81.2, 81.3 të ligjit bazik, rinumërohen si paragrafët 81.2, 81.3, 81.4.

#### **3. Shqyrtimi i propozim vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me emërimin e anëtarëve të bordit për rishqyrtimin e ankesave**

**Kryetarja**, propozimi vendimi i Qeverisë për emërimin e anëtarëve ka qenë më herët në komision dhe është kundërshtuar një kandidatët i cili tashmë me propozimin e ri është hequr nga lista, tash e kemi listën me 4 anëtarë, sepse sipas njoftimit që ka dërguar kryetari i bordit katër anëtar kanë dhënë dorëheqje të parevokusheme.

**Ramadan Avdiu**, ky do të jetë një plotësim i bordit për rishqyrtimin e ankesave dhe kandidatët i kanë plotësuar kushtet e parapara kërkojmë që edhe kuvendi ta miratojë sepse është edhe një

kriter që duhet plotësuar para komisionit evropian.

**Xhevdet Neziraj**, jam kundër sepse po përfshihen vetëm pjesëtarët e komuniteteve që janë në koalicion.

Pas diskutimeve, Komisioni me gjashtë vota Për (Safete Hadergjonaj, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Naser Osmani, Muhamet Mustafa dhe Duda Balje), dy Kundër (Xhevdet Neziraj dhe Sali Asllanaj) dhe një Abstenim (Albana Fetoshi), nxori këtë

## REKOMANDIM

1. Të miratohet propozim-vendim i Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin anëtarëve në Bordin e Pavarur për Rishqyrtimin e Ankesave, me mandat deri më 31 dhjetor 2013, si në vijim: Artan Qerkini, Refik Ramaj, Qemajl Smajli dhe Dragan Djorgovic.

### 4. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2011

**Ymer Havolli**, Trusti i Kursimeve Pensionale përkundër gjendjes së vështirë që ka mbretëruar në tregjet financiare ka mbyllur me fitim bruto prej 3.3 milion. Në fund të këtij viti kemi menaxhuar rreth 588 milion ndërsa brenda një viti kemi akumuluar rreth 108 milion. Mund të konstatojmë si bord se ka qenë një vit i vështirë për shkak të rrezikimit të falimentimit në Bashkimin Evropian dhe ka pasur disa dilema për disa shtete të ndërrimit ose të vënies në rrezik të euros. Trusti ka vazhduar të shpërndajë pensione për kontribuesit e vet dhe numri i të pensionuarve është rritur, pensionistët e rinj janë 2868 pensionistë nga 2700 që ishte një vit më herët. Kemi shpërndarë 5.7 milion ose rreth 1 milion euro më shumë se një vit më parë. Që nga themelimi deri më sot trusti ka shpërndarë pensione në vlerë prej 19 milion e gjysmë. Vlera e mjeteve është rritur nga 488 milion në 588 milion si rezultat i kontributeve të reja të paguara dhe performancës së investimeve. Gjatë vitit 2011 trusti ka operuar me një taksë menaxhuese më të ulët në nivel rajonal me 0.65 %. Pastaj Trusti i propozoj Kuvendit një ulje të taksës në 0.60 nga 1 janari i vitit 2012 ku u miratua kërkesa.

**Kryetarja**, keni marrur vërejtje nga auditori sepse keni theksim të çështjes të shënimi 13 i pasqyrave financiare ku shihet se 19 milion e 320 mijë euro nuk janë atribuuar në llogari të kontribuesve deri më tani. Çka ka ndodhur me ato mjete?

**Vërshim Hatipi**: Këto mjete janë mbetur në mënyrë të vazhdueshme në llogari të trustit që janë të investuara dhe ne jemi në diskutim me bankën Qendrore të hapim një xhirollogari të veçantë ku do të mbahen këto mjete sepse ne nuk kemi të drejtë t'i alokojmë sepse nuk i dihen pronarët sepse mjetet janë ndalur e emrat e kontribuesve nuk janë deklaruar të ATK. Jemi përpjekur ti informojmë përmes shtypit Web faqes, televizionit ti informojmë kompanitë të interesohen për kontribuesit e tyre sepse kemi një pjesë të pa deklaruar dhe ndoshta është nga ta.

**Ardian Zalli** ne kemi kontaktuar punëdhënësit që të na i dërgojnë neve listën drejtpërdrejtë por me ligjin e ri të aprovuar para një muaji parashihet që tash e tutje të mos bëhet asnjë pagesë pa i dërguar listat e punëtorëve. Kjo ka herë në fuqi në 3mujorin e tretë të këtij viti dhe nuk duhet të ketë më mjete të pabarazuara nga muaji korrik e tutje, sa i gjobit ATK ata që nuk deklarojnë është në kompetencë të ATK-së.

**Muhamet Mustafa**, raporti jep mundësi të vlerësohet cilat pika ka sukses dhe në cilat gjendja është dashur të jetë më e mirë. Është shumë e vështirë të vlerësohet suksesi në perioda të

shkurtra në përgjithësi për tregun financiar prapë se prapë nuk mund të jemi shumë të kënaqur sepse prej 2002 deri më tash vlera e aksionit pothuajse ka mbetur e njëjtë ose 5 %. Kam sugjerim që tjetër herë ti paraqitni me tabela të dhënat. Për një dekadë është dashur të jetë një rrije më e madhe. Nëse e shihni investitorin kryesor rreth 35% të mjeteve aty qëndron problemi. Është mirë të diskutohet të ekzistoj një lloj fondi i solidaritetit për punëtorët që dalin në pension në kohën kur vlera e aksioneve është e ulët. Përndryshe ju përgëzoj për nivelin e profesionalizimit. Ju keni 388 mijë kontribuues, 251 mijë kontribuues aktiv pse është kjo diferencë kaq e madhe nuk e kam të qartë.

**Ymer Havolli**, kontribues aktiv janë ata që kanë kontribuar në një vit të caktuar kalendarik të themi në 2011. shumica prej tyre janë organizata shpenzuese buxhetore.

**Latif Gashi**, kemi investime të mjeteve në 3 instrumente që kanë pasur një performancë negative. A vazhdoni ende ti keni mjetet e deponuara aty dhe a keni marrë ndonjë masë të keni një bilanc pozitiv dhe të mos keni performancë negative?

**Ymer Havolli**, trusti ka një strategji të investimeve dhe varet prej reagimeve të tregut financiar. Ajo strategji ka qenë 40% në aksione 60% në letra me vlerë të prasë ose kapitalit. Ne e kemi ditur që në treg në klasë të ndryshme të aseteve mund të ketë rënie dhe klasa tjetër rritje. Kjo është bërë që ne të ruajmë strukturën e përgjithshme të mjeteve të investuara, ta minimizojmë riskun. Nëse kanë rënie aksionet kanë ngritje letrat me vlerë dhe vie deri tek baraspesha e trustit.

**Ardian Zalli**, bordi ka marrë një strategji rreth 20 vjeçare. Janë jo vetëm 20 kompanitë që janë këtu por edhe 1600 tjera dhe ne i kemi paraqitur ato më të mëdhatë. Është diskutuar një formë e figuracionit për individët që dalin në pension në kohë krize por kjo duhet koordinohet me bankën Qendrore.

**Xhevdet Neziraj**, tek organizatat shpenzuese deklarimet ose jo ku shkojnë mjetet e individëve ka qenë një politikë e gabuar e ATK-së ose kujt do qoftë por kjo mund të rregullohet. P.sh tek subjektet politike janë paguar kontributet me emra të personave të kompensuar dhe kanë shkuar në thesar dhe ata shumë në mënyrë të lehtë kanë mundur të barten që të mos kemi probleme tash pas 10 vjetëve ti shikojmë ato dokumente për ti dërguar të kontribuesit.

**Sali Asllanaj**, opinionimi im është se fondi ka qenë me defekte sepse ti heqësh ekonomisë se Kosovës rreth 600 milion dhe t'i dërgosh diku jashtë, si dhe fondin e privatizimit prapë jashtë me qfarë të qëndrojmë në këmbë. Ky është një kursim privat i gjithsecilit ju kemi besuar juve t'i menaxhoni ato mjete, ska solidaritet as mes njerëzve as mes gjeneratave prandaj dua t'i kthehem një skeme tjetër të pensioneve ku solidariteti dhe investimet në Kosovë do ta bënin shumë më të dobishme.

Pas diskutimeve, Komisioni me një votë Abstenim (Albana Fetoshi), asnjë Kundër dhe të gjithë anëtarët tjerë Për, nxori këtë

## REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Raportin vjetor të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2011.

### 5. Shqyrtimi i kërkesës për miratimin e ndryshimit të taksës menaxhuese të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës

**Ardian Zalli**, kemi kërkuar që të rishqyrtohet për t'iu përmbajtur ligjit që ka kaluar në parlament në muajin maj. Citon nenin 5.2 të ligjit për trustin. Kemi propozuar kuvendit të ndryshohet taksa sepse nëse vazhdojmë me atë të njëjtën besoj se marrim më shumë të holla se sa nevojiten sepse aset menaxheret nuk financohen më nga mjetet operationale por nga fondet e investuara. Propozimi ka qenë prej 0.60 të bie në 0.16 kjo nuk ka të bëjë me investitorët.

**Muhamet Mustafa:** A është % automatike?

**Ardian Zalli:** % caktohet në bazë të investimeve dhe parametrave. Ka edhe në bazë të performancës. Këto shpenzime më vonë i bartin kontribuesit e jo trusti. Kjo është rrjedha e ligjit.

**Vërshim Hatipi:** Deri tash me 0.60 janë paguar asetmenaxherët dhe shpenzimet operationale të trustit. Me ligjin e ri mbulimi i asetmenaxherëve kalon në pjesën e fondit ndërsa shpenzimet operationale mbesin si pozicioni i veçantë.

**Latif Gashi,** A nënkupton aprovimi i kësaj kërkesë për taksën menaxhuese 0.16 a ndikon në rritjen e buxhetit të shpenzimeve operative apo vetëm e precizon? A ndryshon buxheti i fondit sepse në të njëjtën kohë bëhet pranimi i ndryshimit të buxhetit për financimin e shpenzimeve operationale ?

**Ymer Havolli,** sipas ligjit të ri asetmenaxherët nuk llogariten shpenzime operationale por si investive dhe vjen zvogëlimi që ligji e parasheh 0.30 maksimum që mund të shkohet. Ne kemi harmonizuar buxhetin dhe ka dalë 0.16.

**Latif Gashi,** për cilën periudhë kohore keni menduar të vlejë kjo kërkesë?

**Ardian Zalli,** Prej korrikut.

**Kryetarja,** lidhur me këtë çështje duhen informata shtesë sepse ne miratojmë vetëm taksën vjetore. Mendoj ta shtymë për një takim tjetër.

Pas diskutimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë

## **PËRFUNDIM**

Shtyhet shqyrtimi i kërkesës për miratimin e ndryshimit të taksës menaxhuese të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, në një mbudhje tjetër të Komisionit.

## **6. Shqyrtimi i Raportit financiar të Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit për vitin 2011**

**Kryetarja,** vlerësoi se raporti i ART-së është i mangët, nuk janë të paraqitura në mënyrë të detalizuar shpenzimet të planifikuara dhe të shpenzuara sipas nënkategorive ekonomike.

**Ekrem Hoxha:** Raportet e njëjta janë dorëzuar edhe tek komisionet tjera dhe te zyra e Auditorit të Përgjithshëm që nuk kanë gjetur vërejtje në raportimet financiare mbi përmbajtjen por gjithsesi ne do t'iu dërgojmë shpalosjen e shpenzimeve për secilën kategori dhe nënkategori. Kategoria shpenzimet kapitale ka pasur shfrytëzim të ulët kjo si pamundësi për të realizuar një

projekt kapital që baret për 2 vite me radhë në projektbuxhetet e aprovuara nga Kuvendi. Mallrat dhe shërbimet në realizim prej 79% dhe komunalit në vlerë 15 mijë euro vije si rezultat i angazhimit të shtuar të projektit nga Komisioni Evropian. ART ka deklaruar si të pashfrytëzueshme si suficit 625 mijë euro, kjo tërheqje e fondeve nga Qeveria shfrytëzimi i buxhetit arrin në masën 80.23% një shkallë e kënaqshme e realizimit. Të hyrat kanë kaluar nga 15.9 milion në 18 milion e 23 mijë euro, 13% tejkalim i të hyrave.

**Latif Gashi**, në raportin e shpenzimeve për 2011 autoriteti juaj ka pasqyruar të hyra dhe shpenzime por nuk është paraqitur si janë planifikuar dhe shpenzuar mjetet brenda një kategorie dhe nuk janë paraqitur krahasimi i shpenzimeve me vitet paraprake. Këto janë shumë të rëndësishme dhe ne nuk mund t'i japim një vlerësim të drejtë të raportit pa këto të dhëna.

**Kryetarja**, propozoi që të shtyjme për një ditë tjetër shqyrtimin e këtij raporti kur të sjellën edhe të dhënat tjera plotësuese.

Pas diskutimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë

## **PËRFUDNIM**

Shtyhet shqyrtimi i Raportit financiar të Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit për vitin 2011 në një mbledhje tjetër të Komisionit. Kërkohet nga ART të dorëzojë një raport plotësues financiar të detalizuar.

### **7. Shqyrtimi i Kërkesës Buxhetore të Kuvendit të Kosovës në bazë të qarkores së parë të Ministrisë së Financave për vitin 2013**

**Kryetarja**, theksoi se në kërkesat e përgatitura nga administrata e Kuvendit, do të ishte mirë t'i keni të përfshirë se sa janë mjete të ndara për vitin 2012 dhe të kemi shënime më të detalizuara dhe të arsyetuara, sepse ne japim mendim dhe marrim përgjegjësinë për kërkesat.

**Ismet Krasniqi**, theksoi se kemi ndryshim të madhë në mes kufirit të përcaktuar nga Ministria e Financave dhe kërkesave tona. Totali i ndryshimeve është 935.757 euro. Në vazhdim sqaroi kërkesat e Kuvendit për vitin 2013 sipas kategorive ekonomike dhe diferencat e kufizuara nga Ministria e Financave.

**Latif Gashi**, do të ishte më mirë të ishin dyer manuale se automatike dhe rreth projekteve tjera siq ishte rrethoja dhe autolarja a i keni koordinuar me komunën e Prishtinës kur dihet që janë duke u bërë disa investime dhe të shiqoni projektin e tyre dhe të mos mbetet autolarja jashtë diku.

**Ismet Krasniqi**, çështja me dilemë është vetëm rrethoja e oborrit, institucioni duhet të ketë një rrethojë. Nëse nuk mund të inkorporohet në projekt, nëse Qeveria largon rrethojat e veta do t'i largojmë edhe ne. Autolarja mendohet në pjesën e brendshme të Kuvendit.

**Muhamet Mustafa**, dallimi në mes kufirit të përcaktuar nga Ministria e Financave dhe kërkesës së Kuvendit në kategorinë e pagave dhe mëditjeve është i madh, pse po ndodhë kështu?

**Kryetarja**, fakti që nga kufiri buxhetor po ndryshon kërkesa në mënyrë drastike për paga dhe

mëditje të hapësirë për diskutim sepse ne mund të shohim arsyeshmërinë për një shumë të mjetëve por 702 mijë e 582 euro është problem të sigurohen. Kisha kërkuar që të jeni më serioz në planifikimin e buxhetit pastaj për mallra dhe shërbime gjithmonë shtohen kërkesat si kur kemi të blejmë mjete të reja si kur nuk kemi. Kërkesat për paga dhe mëditje nuk pajtohemi pa i pasur shënimet e detalizuara se si po shkojnë këto paga, kalkulimet e sakta. Kërkojmë që administrata të analizojë dhe kalkulojë me arsyeshmëri këto pozicione. Tek mallra dhe shërbime kemi rritje të kërkesës mund të kishte kursime. Tek investimet kapitale mos të keni projekte vetëm sa për të hapur tenderë. Tek dyert automatike do të ishte mirë t'i lejmë për këtë vit sepse duhet të kursejmë.

**Istret Azemi**, tek pagat dhe mëditjet kemi kaluar fazën e parë të kornizës afatmesme dhe pavarësisht nga rekomandimi i Komisionit për Buxhet, Ministria e Financave përsëri ka shkurtuar buxhetin. Administrata e Kuvendit për 2013 ka paraparë një rritje për 208 mijë euro që ka të bëjë me pagesën e rregullt të stafit mbështetës politik dhe me rishikim të buxhetit 106 mijë euro shtesë për administratën që do të punësohet në 6 muajin e dytë të këtij viti. Te subvencionet dhe transferet për Kuvendin janë hequr tërësisht, i kemi vetëm për RTK-në, tek investimet kapitale i kemi 3 projekte të financuara.

**Latif Gashi**, mendoj ta lëmë për një takim tjetër qarkorin e parë të buxhetit sepse realisht ka gabime.

**Kryetarja**, konstatoi se të gjithë anëtarët janë në pajtim që të shikohet nga administrata pozicioni i pagës dhe mëditjeve, mallra dhe shërbime, subvencione dhe transfere.

Mbledhja përfundoi në orën 12:40

**Përgatitur nga:**

**Njësia për mbështetjen e Komisionit**

**Kryetarja e Komisionit**

---

**Safete Hadergjonaj**